

Raport Muaji Nëntor 2022

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	22 Nentor 2012
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	250
Shuma minimale pasuese	50
Komisione dhe Tarifa	
Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.30% e vleres neto te aseteve
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Referojuni prospektit te fondit
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.49% per vitin 2021
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.

Nje pjese e rendesishme e aseteteve te fondit mund te investohen ne bono dhe obligacione thesari te Qeverise se Republikes se Shqiperise, te emtuara ne monedhen euro. Megjithate, frekuenca e emtimeve ne euro nga Qeveria e Republikes se Shqiperise do te percaktoje shkallen ne te cilen Fondi do te investoje ne keto lloj instrumentash.

Fondi eshte i pershtatshem per individet dhe subjekte juridike te cilet mendojne se objektivi i investimit i Fondit perputhet me kerkesat dhe pritshmerite e tyre.


Shifra e tarifave të vazhdueshme 1.49% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2021. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.6% ne vit te vlerës neto të aseteteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Invest Euro është në kategorinë e tretë të Profilit të Rrezikut dhe Përfitimit

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik.

Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 30 Nëntor 2022


Vlero Neto e Aseteve	35,227,794
Numri I Investitoreve	1,739
Cmimi I Kuotes	106.0908
*Kthimi Vjetor nga Investimi 30.11.2021 – 30.11.2022)	-9.09%

*Tarifa e administrimit dhe tarifata e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Struktura e Portofolit të investimeve më 30 Nëntor 2022

Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur rrezikun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.

Përçindja e alokimit të asetëve bëhet në përputhje me politikën e investimit dhe kriteret e specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e asetëve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuara në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.



Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit më 30 Nëntor 2022, përçindja e asetëve të fondit e investuar në Obligacione Shtetërore qëndron në 50.4% të asetëve, dhe 47.7% i përkasin obligacioneve të Qeverisë Shqiptare, të tregtuar në tregje ndërkombëtare. Fondi mund të balancojë ekspozimin ndaj instrumenteve të ndryshme në varësi të kushteve të tregut për të arritur objektivat e tij afatgjatë.

Asetet e fondit të investuara në obligacione korporatash dhe fondet investimesh me vlerësim të lartë përbëjnë 38.2% të totalit të aktiveve. Keto fonde investimi gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve. Likuiditeti i mbajtur në cash dhe depozita qëndron në nivelin 11.4% e totalit të asetëve të fondit.


Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin 35.23 milion EUR në fund të muajit Nëntor.

Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës gjatë muajit Nëntor

Gjatë muajit Nëntor cmimi i kuotes është rritur me **+1.46%** në krahasim me muajin e mëparshëm. Nëntori solli një rimëkëmbje të konsiderueshme në tregjet e obligacioneve në përgjithësi, pasi investitorët kanë pritshmëri se inflacioni mund të jetë në kulmin e tij dhe se bankat qendrore mund të përballojnë lehtësimin e politikave të tyre shtrënguese. Kjo shkaktoi një rivlerësim pozitiv të portofolit të investimeve të fondit Euro, i cili rezultoi me fitim gjatë këtij muaji.


Kthimi neto vjetor rezultoi në nivelin -9.09% më 30 Nëntor 2022.

Ecuria e Çmimit të Kuotës Fondi Raiffeisen Invest Euro



Ne dt 30 Nëntor 2022	1 Vit	2 Vite	3 Vite	5 Vite	7 Vite	Nga lancimi (22 Nentor 2012)
Kthimi ne % p.a per periudhen	-9.09%	-5.09%	-3.89%	-1.94%	-0.51%	0.59%

Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Invest Euro per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatsëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investoret e fondit Raiffeisen Invest Euro dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investoret inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Nëntor

Rënia e inflacionit total nga 10.6% në Tetor në 10.0% në Nëntor për Eurozonën shënoi rënien e parë që nga Qershori 2021 dhe ishte më e madhe sesa pritej fillimisht. Zbërthimi i përbërësve të shportës tregoi se rënia më e madhe ishte në inflacionin e energjisë, i cili ra nga 41.5% në 34.9% pasi çmimet më të ulëta të naftës bruto ndikuan edhe në ato të benzinës. Por më e rëndësishmja për BQE-në, norma bazë mbeti e pandryshuar në 5.0%.

Ekonomistët parashikojnë se Banka Qendrore Evropiane do të rrisë edhe dy herë normat e interesit në luftën e saj ndaj inflacionit të lartë, duke përfshirë një rritje më të vogël prej gjysmë pikësh muajin e ardhshëm. Ata gjithashtu presin që BQE të fillojë të shesë trilion euro nga obligacionet e blera gjatë epokës së krizës përgjatë tremujorit të ardhshëm.

Nga ana tjetër, norma vjetore e inflacionit në SHBA u ngadalësua për të katërtin muaj radhazi në 7.7% në Tetor, vlera më e ulët që nga Janari dhe nën parashikimet prej 8%. Megjithatë, shifrat vazhdojnë të tregojnë presione të forta inflacioniste dhe rritje të gjerë të çmimeve në të gjithë ekonominë, kryesisht në sektorin e shërbimeve, ndërkohë që çmimet e mallrave kanë përfituar nga disa përmirësime në zinxhirët e furnizimit.

FED rriti normën e saj bazë me 75 pikë të tjera në takimin e 2 Nëntorit, në intervalin 3.75% - 4.00%, por, në deklaratën shoqëruese, hodhi bazat për një rritje prej 50 pikësh në mbledhjen e ardhshme në mesin e Dhjetorit. Kryetari Jerome Powell çimentoi pritshmëritë se Rezerva Federale do të tërhiqet nga ritmi i saj agresiv i politikave shtrënguese në Dhjetor dhe paraqiti një plan për arritjen e një inflacioni më të ulët pa e futur ekonominë në një recesion të thellë.

Nëntori solli një rimëkëmbje të konsiderueshme në tregjet e obligacioneve në përgjithësi, duke shtuar një rekord prej 2.8 trilionë dollarësh në vlerën e tregut dhe indekset e obligacioneve u rritën me 5%, pas disa muajsh rënieje. Yield-et e obligacioneve qeveritare ishin shumë më të ulëta dhe spread-et u zvogëluan në tregjet globale. Megjithatë, kurba e yield-eve në SHBA u përmbys më tej, duke arritur në 70 pikë, një shenjë se ekonomia amerikane do të pësojë rënie vitin e ardhshëm. Gjithashtu, të dhënat ekonomike vazhduan të tregojnë pritshmëri për një recesion në Europë.

Në vazhdim, megjithëse inflacioni në eurozonë u moderua në Nëntor për herë të parë që nga mesi i vitit 2021, ai do të qëndrojë i lartë edhe për disa kohë, pasi lufta mes Rusisë dhe Ukrainës ushqen krizën energjetike të kontinentit.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një epërtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analizë të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në faqen zyrtare www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.